



Datë: 15.01.2026  
Numër Protokolli: 163/2026

A.nr.1376/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** –Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe *Malsore Gashi Bajraktari*, anëtarë, më Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1376/2025, të datës 16.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.B, kundër organit të punësimit: Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.01.2026, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1376/2025, e datës 16.07.2025, e parashtruar nga ankuesi A.B.

**II. Mbetet në fuqi** Akti-Lista më numër protokolli 319, e datës 09.07.2025, e Komisionit të Pranimit lidhur më rezultatet përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, në procedurën e gradimit më nr. reference MD/SHKK/13-14/08/2024, pozita e punës Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, Shërbimi Korrektues i Kosovës.

## A r s y e t i m

Ankuesi, A.B (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 16.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Konkursit të Brendshëm të gradimit me nr. reference MD/SHKK/13-14/08/2024, pozita Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, të shpallur më datë 26.08.2024 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, ky i fundit, ka dorëzuar përgjigjet në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit)**  
**administroi këto prova:** Ankesën me numër protokolli 4749/2025, të parashtruar nga ankuesi më datë 16.07.2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës; Kërkesën për përgjigje në ankesë; Përgjigjen në ankesë të datës 01.09.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punësimit; Regjistri i kërkesave të pranuar për konkursin e brendshëm; Konkursin me Nr.reference MD/SHKK/13-14/08/2024 të datës 26.08.2025; Listën e rezultateve përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistës me gojë të datës 09.07.2025; Listën e rezultateve të intervistës me gojë të datës 07.07.2025; Pyetjet nga Intervista me Gojë për pozitën Mbikëqyrës në Qendrën e paraburgimit në Prishtinë; Ftesën për intervistë me gojë të datës 27.06.2025; Njoftimin e datës 23.06.2025; Njoftimin e datës 16.06.2025; Pyetjet e intervistës me gojë nga Komisioni i Pranimit të datës 04.07.2025; Vendimin për themelimin e komisionit të pranimit të datës 09.06.2025; Procesverbalin; Kërkesën për interpretim të datës 08.07.2025; Akt emërimit me Nr.279/2024, të datës 01.08.2024; Testin me shkrim të kandidatit B.K të datës 21.06.2025; Plotësimin dhe Ndryshimin e Akt emërimit me Nr.438/2024 të datës 11.06.2025; Kërkesën për punësim të kandidatit L.S të datës 10.09.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Testin me shkrim për kandidatin L.S i datës 21.06.2025; Testin me shkrim për kandidatin H.G 21.06.2025; Kërkesën për punësim të kandidatit H.G i datës bashku me 02.09.2025 së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Kërkesën për punësim të datës 09.09.2025 kandidatit B.K së bashku me dokument e bashkangjitura; Kërkesën për punësim të datës (pa datë) kandidatit A.B së bashku me dokument e bashkangjitura; Vendimin me numër protokolli 5839/2025, të kryetarit të Këshillit; Profat shtesë të dërguara më datë 30.12.2025, nga Shërbimi Korrektues i Kosovës: Vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2024, të datës 20.02.2025 të L.S; Kopjen e letërnjoftimit; Kontratën e Punës për L.S, të datës 15.07.2020; Vendimin me Nr.338, të datës 17.03.2023 për caktimin e H.G si zëvendësues i Mbikëqyrësit në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë; Kontratën e punës për H.G të datës 15.07.2025; E-mailin e Këshillit të datës 08.01.2026; Përgjigjen e SHKK, të datës 08.01.2026; Kërkesën e datës 09.01.2026; Përgjigjen e datës 09.01.2026 së bashku me dokumentin e kërkuar: Diplomën me Nr.157; Kërkesën e datës 12.01.2026; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.01.2026; Dosjet e kandidatëve fitues, L.S, B.K dhe H.G.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **sepse:**

#### *Vlerësimi i gjendjes së fakteve*

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se:

- Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 26.08.2024, ka shpallur Konkursin e Brendshëm( gradimit) me numër reference: MD/SHKK13-14/08/2024, për pozitën e punës Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, tre (3) pozita.
- Në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsej trembëdhjetë (13) kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesi, i cili i është nënshtruar testit me shkrim dhe intervistës me gojë, ndërsa, pas përfundimit të procesit të rekrutimit, organi përkatës i punësimit më datë 19.12.2024, ka publikuar listën e rezultateve përfundimtare me numër protokolli 505, ku sipas kësaj liste si kandidatë më më së shumë pikë kanë

qenë B.K me 91.5 pikë dhe H.G me 88.2. Kurse, ankuesi sipas listës së rezultateve përfundimtare ka arritur vetëm 46 pikë.

-Ankuesi më datë 03.01.2025, kishte parashtruar ankesë në KPMSHCK-së kundër listës së rezultateve përfundimtare me numër protokolli 505, të datës 19.12.2024, të publikuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, lidhur me konkursin e brendshëm për Gradën Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

-KPMSHCK-ja duke vendosur sipas ankesës së ankuesit të datës 03.01.2025, më Vendimin A.nr.04/2025, të datës 14.04.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit Anr.04/2025, të datës 03.01.2025 e, ashtu që, ka anuluar Listën me numër protokolli 505, të datës 19.12.2024, për shpalljen e rezultateve përfundimtare ( testim me shkrim dhe intervistës më gojë), si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarr në fazën e vlerësimit, lidhur me konkursin e brendshëm për gradën Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë/Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa, çështja është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e vlerësimit profesional, duke obliguar Drejtorin e Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të vendimit, të themeloj Komisionin e ri të gradimit, në pajtim me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, ndërsa, ky i fundit obligohet të zhvilloj procedurën e vlerësimit profesional të kandidateve në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

- Në zbatim të Vendimit të KPMSHCK-së A.nr.04/2025, të datës 14.04.2025, Drejtori i Përgjithshëm i SHKK-së më Vendimin nr.prot:749, të datës 11.06.2025, ka themeluar Komisionin e Pranimi për vlerësimin e kandidateve në procedurën e kontestuar gjegjësisht për pozitën Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, ndërsa, ky i fundit ka ri zhvilluar fazën e vlerësimit profesional të kandidateve.

-Ankuesi sipas shkresave të lëndës ankuesi në testin me shkrim ka arritur 78.5 pikë, ndërsa, në intervistën më gojë më 38.3 pikë, gjithsej 58.4 pikë.-

Më datë 09.07.2025, Komisioni i pranimi ka publikuar listën e rezultateve përfundimtare të testit me shkrim dhe intervistës me gojë, sipas së cilës listë rezulton së si kandidatë fitues janë: H.G më gjithsej 84.65 pikë, B.K me gjithsej 85.8 pikë dhe L.S më gjithsej 84.9 pikë.

### *Pretendimet ankimore*

Ankuesi në ankesën e parashtruar më datë 16.07.2025 pretendon së parregullsitë kanë vazhduar edhe me rastin e formimit të komisionit të ri të vlerësimit sipas Vendimit të datës 11.06.2025, pasi që zyrtari i burimeve njerëzore nuk është pjesë e Departamentit të NJBNJ në nivel qendror; testi me shkrim është caktuar më datë 21.06.2025, që rezulton të jetë ditë vikendi (e shtunë), nën supozimin se ka dyshime për mungesë transparence dhe mundësi manipulimi. Shton se ka qenë një dallim i madh në vlerësim nga rezultati i mëparshëm. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe procesin e rekrutimit për pozitën Mbikëqyrës ta kthej në pikën zero, duke u dhënë mundësi të gjithë kandidatëve të interesuar të aplikojnë.

## *Vlerësimi i Kolegjit*

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës materiale të Këshillit për shqyrtim dhe vendosje lidhur me çështjen në procedurë, Kolegji i Këshillit konstatoi se procedura e kontestuar kishte filluar në kohën ku ende nuk ka qenë në fuqi Ligji Nr. 08/L-294 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtaret Publikë, rrjedhimisht, me rastin e shpalljes së konkursit MD/SHKK13-14/08/2024, më datë 26.08.2024, zyrtaret korrektues kanë pas statusin e nëpunësit civil me status të veçantë siç përcaktohej me nenin 6, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku shprehimisht thuhej se: *“1. Nëpunësja/i civil me status të veçantë është nënkategori e nëpunëses/it civil, ku bëjnë pjesë: 1.1. të punësuarat/it e shërbimit korrektues.... 2. Rregullimi me ligj të veçantë për nëpunësen/in civil me status të veçantë, sipas paragrafit 1. të këtij neni, duhet të jetë në pajtim me parimet e përcaktuara me këtë ligj dhe mund t'i rregullojë ndryshe vetëm elementet e marrëdhënies së punës, si në vijim: 2.1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. trajnimet dhe zhvillimin profesional; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve; 2.6. përcaktimin e shkeljeve dhe masave disiplinore shtesë; 2.7. disiplinën dhe vlerësimin. Andaj, nisur nga këto rrethana juridike Këshilli ka kompetence lëndore që të shqyrtoj dhe të vendos lidhur me ankesën e ankuesit.*

Kolegji i Këshillit mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *“Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”,* lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e konkursit me numër reference MD/SHKK/13-14/08/2024, të datës 26.08.2024 dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kandidatët që aplikojnë për pozitën e punës Mbikëqyrës duhet ti përmbushin këto kritere: *Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës; të kenë zotësi të plotë për të vepruar; të zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët; të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për kryerjen e detyrës përkatëse; të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje; të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune në Gradën I; të ketë përgatitje universitare; në dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar “mirë”; të mos ketë masë disiplinore aktive; Dëshmi nga Gjykata që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij. Ndërsa, si dokumente të kërkuara janë vendosur: *Formulari i aplikimit, Kontrata e punës, Kopjen e diplomës universitare, Vërtetimi nga Gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetim, Vërtetim nga Policia për të kaluarën kriminale, kopjen e dy vlerësimeve të fundit 2022 dhe 2023, kopjen e letërnjoftimit dhe pasaportës, dëshmi lidhur me masë disiplinore dhe dëshmi për kualifikimet tjera.**

Kolegji i Këshillit nisur nga fakti se SHKK posedon autorizim ligjor që të rregullojë në mënyrë veçantë çështjen e avancimit-gradimit, atëherë, mbi këtë bazë të përcaktimit kolegji iu referua Udhëzimit Administrativ MD Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, më theks të veçantë:

- **Nenit 3:**Sistemi i Gradave: *1.Sistemi i gradimit për zyrtarët korrektues është në përputhje me gradat si në vijim: 1.1. Kadet për Zyrtar Korrektues; 1.2. Zyrtar Korrektues; 1.3. Mbikëqyrës; 1.4. Mbikëqyrës i Lartë; 1.5. Udhëheqës i Njesisë.*

**-Nenit 7:** Konkursi për Gradim I. Avancimi për Gradën II, III dhe IV bëhet përmes konkursit të brendshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës. 2. Konkursi për avancim në gradat nga paragrafi 1 i këtij neni përmban: 2.1. emrin e institucionit; 2.2. pozitën dhe përshkrimin e vendit të punës; 2.3. koeficientin e gradës; 2.4. dokumentacionin e nevojshëm për aplikim; 2.5. testet të cilave do t'u nënshtrohet kandidati; 2.6. vendin dhe adresën e saktë ku merren dhe dorëzohen aplikacionet; 2.7. afatin për pranim-dorëzim të aplikacioneve.

**-Nenit 8:** Kriteret për Gradën Mbikëqyrës 1. Kandidatët që aplikojnë për Mbikëqyrës, përkatësisht për avancim në Gradën II përveç kushteve të përgjithshme që parashihen me legjislacionin në fuqi duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim: 1.1. të ketë së paku tri (3) vite përvojë pune në Gradën I; 1.2. të ketë përgatitje universitare; 1.3. dy vlerësimet e fundit vjetore të jetë vlerësuar me të paktën arrinë pritshmëritë; 1.4. të mos ketë masë të shqiptuar disiplinore aktive; 1.5. dëshmi nga gjykata që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij.

**-Nenit 11** Komisioni për procesin e gradimit 1. Komisioni themelohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm. 2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë nga zyrtarët e Shërbimit Korrektues. 3. Kryesuesi dhe njëri anëtarë i Komisionit duhet të ketë së paku një (1) gradë më të lartë se grada për të cilën zhvillohet procedura e rekrutimit. Anëtari i tretë i Komisionit duhet të jetë nga Njësia e Burimeve Njerëzore. 4. Komisioni për procesin e gradimit shqyrton dhe vlerëson aplikacionet e pranuar për gradim. 5. Njësia e Burimeve Njerëzore mbështetë punën e komisionit për gradim.

Kolegji i Këshillit referuar kuadrit ligjor si me sipër, e në kuptim të pretendimit ankimor lidhur me përbërjen e komisionit të pranimit, ka analizuar shkresat e lëndës nga dhe ka konstatuar së më Vendimin me numër protokoli 749, të datës 11.06.2025, të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, është emëruar komisioni përzgjedhës për procesin e gradimit për pozitat Mbikëqyrës dhe Mbikëqyrës i Lartë në përbërje nga: F.A, kryesues, i cili sipas Akt emërimit me Nr.279/2024 të datës 01.08.2024, mbanë pozitën Udhëheqës për Siguri në Qendrën Korrektuese në Smrekonicës, Sh.B, anëtar, e cila sipas Kontratës së Punës së datës 30.06.2020, mbanë pozitën e punës Udhëheqëse për Siguri në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, si dhe A.B, anëtar, i cili sipas Akt emërimit me Nr.438/2024 të datës 11.06.2024, mbanë pozitën e punës Zyrtar i Lartë i Personelit në Divizionin për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Lokacioni Dubravë. Andaj, në vlerësimin e Kolegjit përbërja e Komisionit ka qenë në pajtim më nenin 11 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues, mbi arsyet se kryesuesi F.A dhe anëtari SH.B kanë pozitë të gradës më të lartë se pozita e shpallur pasi që mbajnë pozita të udhëheqësve të njësive, ndërsa, anëtari A. B mbanë pozitën e zyrtarit të lartë të personelit në kuadër të Divizionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, lokacioni Dubravë. Rrjedhimisht, pretendimi se nuk ka zyrtar të personelit nga qendra nuk gjen mbështetje ligjore sepse një kërkesë e tillë nuk parashihet me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues.

Përkitazi më pretendimin se testi me shkrim është caktuar në ditë vikendi pra ditë e shtunë, Kolegji thekson faktin se sipas praktikës së gjertanishme institucionet për arsye objektive (si mungesë sallave, numër të madh të kandidateve, realizmit me kohe të detyrave zyrtare gjatë ditëve zyrtare të punës) kanë zhvilluar testet me shkrim edhe në ditët e vikendit, andaj, duke qenë se testi me shkrim është mbajtur për të gjithë kandidatët në të njëjtën ditë dhe më pyetje të njëjta, atëherë, mbi këto rrethana nuk vërehet ndonjë diskriminim apo mos trajtim i barabartë i ankuesit në raport me kandidatët tjerë, kështu që

pretendimi ankimor mbi këtë shkak nuk gjen mbështetje ligjore. Rrjedhimisht, në kontekst të pretendimit ankimor të ankuesit se në fazën e vlerësimit të testit me shkrim ka pas mundësi për manipulim dhe mungesë transparence, për Kolegjin e Këshillit një fakt i tillë nuk ka qenë i mundur të argumentohet sepse pala ankuese nuk ka arrit të ofroj ndonjë dëshmi që provon një pretendim të tillë.

Në kuptim të respektimit të parimit të meritokracisë si një nga parimet bazë në çdo procedurë të pranimit në pozitat përkatëse, Kolegji ka analizuar dosjet e kandidateve fitues në këtë procedurë, nga dhe ka gjetur këtë gjendje të fakteve:

**-Kandidati L.S** sipas aplikacionit të datës 10.09.2024, posedon Diplomën me numër Nr.162, të datës 04.06.2024, të lëshuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike, për përfundimin e studimeve themelore më datë 10.05.2024, në Fakultetin e Sigurisë Publike, ndërsa përkitazi me kriterin e përvojës së punës, nga shkresat e lëndës rrjedhë së kandidati është i punësuar në SHKK, në pozitën e Zyrtarit Korrektuese, pozitë të cilën e ushtron nga data 01.10.2013 e tutje. Lidhur me dokumentacioni tjetër të kërkuara posedon ID-n më datë të lëshimit 27.10.2016 dhe fat te vlefshmërisë deri 26.10.2026, Formularin e datës 05.01.2024, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2023, më notë të përgjithshme 3.41; Formularin e datës 11.01.2023, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, me notë të përgjithshme 3.95; Certifikatën mbi Dënimet Penale Nr.ser.C04D18EEF6FE9438, të datës 29.08.2024, të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me të cilën vërtetohet se nuk është i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë; Vërtetimin Nr. Reference EK-2024-AE-2433 të datës 27.08.2024, të lëshuar nga Policia e Kosovës, me të cilin vërtetohet se nuk ka dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës; i dhe Vërtetimin e datës 09.05.2024, të lëshuar nga njësia e personelit të SHKK-së, më të cilin është konfirmuar së kandidati L.S, nuk ka në fuqi masë disiplinore.

**-Kandidati H.G** sipas aplikacionit të datës 02.09.2024, posedon Diplomën me numër Nr.108, të datës 05.07.2022, të lëshuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike, për përfundimin e studimeve themelore më datë 04.03.2022, në Fakultetin e Sigurisë Publike, ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës sipas shkresat e lëndës rrjedhë së kandidati është i punësuar në SHKK, në pozitën e Zyrtarit Korrektuese, pozitë të cilën e ushtron nga data 01.10.2008 e tutje. Lidhur me dokumentacioni tjetër të kërkuar posedon ID-ne më datë të lëshimit 04.03.2022, dhe afat të vlefshmërisë 03.03.2032, Formularin e vlerësimit ( i nxjerr sipas SIMBNJ lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, më notë të përgjithshme 4 ( shumë mirë), Formularin e datës 11.01.2024, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2023, më notë të vlerësimit 4 të objektivat (nuk ka notë të përgjithshme); Certifikatën mbi Dënimet Penale Nr.ser.C9B7C44054F4CC, të datës 27.08.2024, të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me të cilën vërtetohet se nuk është i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë, Vërtetimin Nr. reference EK-2024-AH-1821 te datës 27.08.2024, të lëshuar nga Policia e Kosovës, me të cilin vërtetohet se nuk ka dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës si dhe Vërtetimin e datës 09.05.2024, të lëshuar nga Udhëheqësi i Administratës, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, më të cilin është konfirmuar së kandidati H.G nuk ka në fuqi masë disiplinore.

-**Kandidati B.K** sipas aplikacionit të datës 09.09.2024, posedon Diplomën me numër Nr.175, të datës 18.09.2024, të lëshuar nga Akademia e Kosovës për Siguri Publike, për përfundimin e studimeve themelore më datë 05.07.2024 në Fakultetin e Sigurisë Publike, ndërsa, lidhur me kriterin e përvojës së punës sipas shkresat e lëndës rrjedhë së kandidati është i punësuar në SHKK, në pozitën e Zyrtarit Korrektuese, pozitë të cilën e ushtron nga data 01.11.2004 e tutje. Lidhur me dokumentacioni tjetër të kërkuar posedon ID-ne më datë të lëshimit 03.05.2019, dhe afat të vlefshmërisë 02.05.2029, Formularin e datës 10.01.2024, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2023, më notë të përgjithshme 5; Formularin e datës 11.01.2023, lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2022, më notë të vlerësimit 4 të objektivat (nuk ka notë të përgjithshme), Certifikatën mbi Dënimet Penal Nr.ser.F147F13CFA92471, të datës 03.09.2024, të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me të cilën vërtetohet se nuk është i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë, Vërtetimin Nr. reference RN-2024-AC-1541 të datës 05.09.2024, të lëshuar nga Policia e Kosovës, me të cilin vërtetohet se nuk ka dosje penale në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës si dhe Vërtetimin e datës 09.05.2024, të lëshuar nga Udhëheqësi i Administratës, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, më të cilin është konfirmuar së kandidati B.K nuk ka në fuqi masë disiplinore.

Mbi bazën e konstatimeve si me sipër, rrjedhë se kandidatët fitues në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë plotësuar kriteret e përcaktuar për pozitën e kontestuar, e duke qenë se të njëjtit kanë arritur numrin më të madhe të pikëve të vlerësimit, atëherë, organi i punësimit ka shpallur të njëjtit kandidatë fitues.

Theksuar si më sipër, dhe meqenëse nuk është evidentuar ndonjë shkelje esenciale e karakterit procedural apo material, Kolegji vlerëson se procedura e pranimi sipas konkursit me numër të referencës: MD/SHKK/13-14/082024, për pozitën e punës Mbikëqyrës në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë, është zhvilluar në pajtim Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, Ligjin 08/L-131 për Shërbimin Korrektues dhe Udhëzimin Administrativ MD-Nr07/2024 për Gradat e Zyrtarëve Korrektues të Kosovës,

Kështu që duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*A.nr.1376/2025*

**Kaltrina Avdullahi Prenaj**

*Procesmbajtëse*

**Ardita Haxhnikaj Demi**

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit, A.B;
- SHKK: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KMPSHCK-së